



**KONTRATE
SHITBLERJE KUOTASH**

Ne Tirane sot me date 15/05/2007 perpara meje noterit Asim Zeka, ne mbeshtetje te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe legjislacionit civil ne fuqi te Republikes se Shqiperise lidhet kjo kontrate shitblerje kuotash midis paleve:

SHITESI: Besnik Hashani, i biri i Rasimit lindur me 1953 ne Bajram-Curri dhe banues ne rr. "Komuna e Parisit" prane UNY Tirane.

BLERESI: z.Ludovic Laventure, i biri i Rene, lindur me 07.11.1967 ne France dhe banues ne "Bourg En Bresse AIN France", me banim te perkohshem ne rr. "Myslym Shyri", pall.63/1, ap.19 Tirane.

Te dy palet bien dakort si me poshte:

NENI 1

Shitesi Besnik Hashani eshte ortak i vetem ne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "Kristal Communication" sh.p.k. me nje kapital prej 100.000 lekesh dhe zoteron 100% te kapitalit te kesaj shoqerie. Nje gje te tille vertetohet nga vendimi nr.36474 date 01/11/2006 bashkengjitur kesaj kontrate.

NENI 2

z.Besnik Hashani me vullnetin e tij te lire i shet pjesen prej 73% e kapitalit te tij, z.Ludovic Laventure. Nje gje e tille eshte vendosur ne menyre unanime me vendim nr.1 ne mbledhjen e asamblese se ortakeve te shoqerise "Kristal Communication" sh.p.k.

NENI 3

Me nenshkrimin e kesaj kontrate shitesi Besnik Hashani pushon se qeni ortak i vetem dhe administrator ne shoqerine "Kristal Communication" sh.p.k., ndersa bleresi z.Ludovic Laventure behet ortak mazhoritar i kesaj shoqerie duke zoteruar 73% te kapitalit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Kristal Communication", dhe 27% i mbeten z.Besnik Hashani.

NENI 4

Administrator i kesaj shoqerie do te jete z.Ludovic Laventure.

NENI 5

Kontrata e shitblerjes perpilohet ne tre kopje me fuqi te barabarte seicila dhe mbasi shpreh vullnetin e lire te paleve nenshkruhet prej tyre.

SHITESI

ASIM ZEKA
TIRANE

BLERESI

LUDOVIC LAVENTURE



Besnik Hashani
Edlira Hysa

Asim Zeka

Ludovic Laventure